



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

MINISTRI

Nr. 1216/prot.  
1

Tiranë, më 13.2.2024

UDHËZIM

Nr. 3, datë 13.2.2024

PËR

**DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 14, DATË 27.05.2019  
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PËRGATITJEN  
DHE LËSHIMIN E KARTËS SË STUDENTIT”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 100 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe të vendimit nr. 226, datë 17.04.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve, të ofruara nga entet shtetërore dhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktura përmes përdorimit të kartës së studentit”,

UDHËZOJ:


1. Në udhëzimin nr. 14, datë 27.05.2019 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përgatitjen dhe lëshimin e kartës së studentit”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a) Kudo në përmbajtjen e udhëzimit togfjalëshi “*Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë*”, zëvendësohet me togfjalëshin “*Ministria përgjegjëse për arsimin*”.
  - b) Pika 3, riformulohet si më poshtë:  
“3. *Studenti mund të përfitojë kartën e studentit kur ai regjistrohet pranë një institucioni të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*”.
  - c) Pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me përmbajtjen si më poshtë:  
“3/1. *Institucioni i arsimit të lartë brenda vitit akademik përcjell pranë institucionit përgjegjës për emetimin e kartave të studentit listën e studentëve të rinj të pajisur me Numrin Identifikues Matrikullimi (NIM) nga QSHA*”.

d) Pika 7 e shkronjës “a”, të shtojcës nr. 1 “Udhëzuesi Teknik” zëvendësohet si më poshtë:

*“7. Numri Identifikues ID (NID);”*

2. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe institucionet e arsimit të lartë për zbatimin e këtij udhëzimi.

*Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.*

  
MINISTRI  
OGERTA MANASTIRLIU

